



## Periodiku AMF

### I. Praktika të mira në menaxhimin e riskut të investimeve alternative nga fondet e pensioneëve.

Objektiva e mbikëqyrjes së pensioneëve është të mbrojë interesin e anëtarëve dhe përfituesve të fondeve të pensioneëve dhe të ruaje stabilitetin e industrisë së pensioneëve dhe sistemit financiar si të tërë. Duke marrë në konsideratë shpejtësinë dhe kompleksitetin në rritje të tregjeve financiare, Autoritet e Mbikëqyrjes së Fondeve të Pensioneëve duhet të jenë të përgatitur për zhvillimet që mund të shkaktojnë sfida për këtë objektive.

Përdorimi më i gjerë i formave alternative të investimit, të tilla si (fondet e) fondeve mbrojtëse dhe investimet në letra me vlerë të mbështetura në pasuri të paluajtshme, janë një zhvillim i konsiderueshëm.

*Vijon në faqen 2*

### II. Vështrim mbi tregun e Sigurimeve

Në muajin Janar 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 479,800 mijë lekë, përkundrajt 436,599 mijë lekë të realizuara në muajin janar 2007.

Tregu i sigurimeve ka një rritje në masën 9.89 % në krahasim me muajin janar të vitit të kaluar, ku 82.36 % e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 17.64 % tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 40.01 % të sigurimeve të Jetës dhe 8.52 % të sigurimeve të Jo – Jetës.

*Vijon në faqen 8*

### III. XBRL: Drejt një gjuhe të përbashkët të Raportimit Financiar

Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) ka qenë në biznesin e vendosjes së standarteve për 23 vjet. Paraqitjet e saj ndërkombëtare kanë fituar mbështetjen për cilësinë e lartë, aktualitetin dhe përshtatshmërinë në kuadrin e harmonizimit global. Në një pamje të zgjeruar, IFAC po punon me rregullatorë, agjensi ndërkombëtare dhe të tjerë për të inkurajuar qeveritë në prezantimin e strukturave, sistemeve dhe kontrolleve të cilat bëjnë një qeverisje të mirë.

*Vijon në faqen 9*

### IV. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

*IV/I. Konferenca Rajonale "Mbi rolin e institucioneve rregullatorë të fondeve private të pensioneëve në kuadër të implementimit të direktivave të BE-së"*

Në datën 30 Janar 2008, në Shkup të Maqedonisë u zhvillua konferenca rajonale "Roli i institucioneve rregullatore në sigurimin e pensioneëve tërësisht të kapitalizuara në linjë me plotësimin e Direktivave të Bashkimit Europian".

Seminari u realizua nga Këshilli i Europës nën "Programin e mbrojtjes së institucioneve sociale" të CARDS.

*IV/II. Konferenca Rajonale "Reformat ligjore në rajonin e Ballkanit, për mbrojtjen e konsumatorit në fusha të ndryshme dhe shërbimet financiare jobankare"*

Në datat 4 dhe 5 shkurt 2008, u organizua në Zagreb të Kroacisë takimi rajonal mbi reformën ligjore në rajonin e Ballkanit, përsa i përket mbrojtjes së konsumatorit në fusha të ndryshme ndër të cilat dhe ajo për shërbimet financiare jobankare.

*Vijon në faqen 11*

## Në këtë numër:

Praktika të mira në menaxhimin e riskut të investimeve alternative nga fondet e pensioneëve. **2**

Vështrim mbi tregun e sigurimeve **8**

XBRL: Drejt një gjuhe të përbashkët të Raportimit Financiar **9**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **11**

## Praktika të mira në menaxhimin e riskut të investimeve alternative nga fondet e pensioneve

Objektiva e mbikëqyrjes së pensioneve është të mbrojë interesin e anëtareve dhe përfituesve të fondeve të pensioneve dhe të ruaje stabilitetin e industrisë së pensioneve dhe sistemit financiar si të tërë. Duke marrë në konsideratë shpejtësinë dhe kompleksitetin në rritje të tregjeve financiare, Autoritet e Mbikëqyrjes së Fondeve të Pensioneve duhet të jenë të përgatitur për zhvillimet që mund të shkaktojnë sfida për këtë objektivë. Përdorimi më i gjerë i formave alternative të investimit, të tilla si (fondet e) fondeve mbrojtëse dhe investimet në letra me vlerë të mbështetura në pasuri të paluajtshme, janë një zhvillim i konsiderueshëm. Përderisa entitet e pensioneve janë duke vendosur një pjesë të kapitalit të tyre në këto tipe instrumentash, risku potencial që kalon nga këto produkte justifikon vëmendjen specifike nga autoritetet mbikëqyrëse. Mënyra se si mbikëqyrësit përgjigjen ndaj këtyre risqeve varion në varësi të metodave të mbikëqyrjes të adaptuara. Sidoqoftë, të gjithë mbikëqyrësit presin që të adaptohen metoda të menaxhimit të riskut që marrin në konsideratë riskun që del nga investimet alternative. Me qëllim të mbështetjes së mbikëqyrësve ndërsa ata qartësojnë dhe artikulojnë këto objektiva (pritje), IOPS ka zhvilluar një bashkësi praktikash të mira “Good Practices, Gp<sup>2</sup>” të cilat përshkruhen në këtë dokument, duke skicuar njohuritë dhe dijet e mbikëqyrësve. Megjithatë, në shumicën e juridiksioneve përgjigjet e mbikëqyrësve bazohen në rregullore. Përputhja e planeve dhe fondeve me këtë rregullore monitorohet nga autoritet mbikëqyrëse, psh nëpërmjet mbikëqyrjes off and on – site dhe një vlerësimi në thellësi të fondeve të pensioneve.

Nuk ekziston një përcaktim i prerë i investimeve alternative. Koncepti është i një natyre dinamike dhe ngushtësisht i lidhur me zhvillimin e tregjeve financiare. Në praktikë, investimet alternative karakterizohen nga veçori të cilat i dallojnë ato nga investimet tradicionale, të tilla si: aplikimi i produkteve dhe derivateve financiare inovative, përdorimi i leveve financiare në mënyrë ekstensive, natyra jolikuidie e investimeve ku ato mbështeten, mbështetja më e madhe në aftësinë e menaxherit dhe mungesa e krahasimeve/kufijve kuptimplotë. Në këtë fazë, një listë jo ezauruese e tipeve të miratuara të investimeve alternative do të përfshijë fondet mbrojtëse, kapitalin privat, investimet në pasuri të luajtshme të sigurta etj. Karakteristika të ndryshme të investimeve alternative kanë ndikim në profilin e tyre të riksut. Çështjet kyçe që janë me të lidhura me investimet alternative të cilat kanë nevojë që të trajtohen në menaxhimin e riskut të fondeve të pensioneve janë: risku i likuiditetit, risku operacional, transparenca e kufizuar, dobësi të vlerësimit, çështjet e kontrollit dhe konflikti i interesit.

Autoritet Mbikëqyrëse dinë që, në parim, ka vend për investime alternative brenda fondeve të pensioneve. Fondet alternative të investimeve mund të gjenerojnë shanse për një menaxhim më të mirë ose për të zvogëluar riskun total të portofolit duke diversifikuar asetet, dhe duke lejuar fondet e pensioneve, si investues afatgjatë, të përfitojnë prej primit të likuiditetit që mund të shoqërojë instrumentet më pak likuide. Sidoqoftë, autoritetet e mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve dinë që strategjitë më riskuese trashëgohen shpesh në investimet alternative, duke ditur që ato janë dizenuar fillimisht për individët me pasurit të mëdha (me një tolerancë konsekuative risku). Investime të tilla mund të jenë komplekse, jolikuide ose opake, dhe për pasojë kërkojnë një analizë dhe inspektim të kujdeshëm, dhe në shumicën e rasteve, një rishikim dhe monitorim më rigoroz se shumica e produkteve tradicionale – veçanërisht kur përfshihen investitorët potencialë vulnerabël, si përfituesit e fondeve të pensioneve. Kujdestarët/të besuarit (fiduciaries) duhet për këtë qëllim të shqyrtojnë me kujdes riskun në të cilin po ekspozojnë anëtarët e fondeve.

<sup>1</sup> IOPS – International Organization of Pension Supervisors, Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve

<sup>2</sup> Good practices – Praktika të mira. Në material do të përdoret shkurtimi GP.

Një fond pensionesh vetë, ka përgjegjësinë të realizojë menaxhim adekuat të riskut për investime alternative dhe të përmbushë çdo dispozitë statutore. Autoritetet e mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve kërkojnë të sigurojnë që kujdestarët/të besuarit të identifikojnë dhe shpërndajnë me mënyrë të drejtë riskun e shoqëruar me këto investime. Nën dritën e parimit bazë të IOPS për proporcionalitetin, përgjigjia e autoriteteve mbikëqyrëse kundrejt riskut të investimeve alternative duhet të marrë në konsideratë situatat specifike të fondeve të pensioneve që mbikëqyrin dhe natyrën e riskut të investimeve alternative që mban. Kjo nuk do të thotë që kërkesat e mbikëqyrësve për fondet e vogla dhe të thjeshta të pensioneve duhet të jenë më të pakta, por kjo mund të nënkuptojë që mund të bëhet një diferencim në mënyrën se si entitet e pensioneve në mënyrë individuale aplikojnë teknikat e menaxhimit të riskut në praktikë, ose në përjasjen që autoritetet mbikëqyrëse bëjnë në lidhje me adekuacitetin dhe korrektësinë e menaxhimit të riskut të aplikuar nga fondet e pensioneve në këto investime.

Në përputhje me parimet bazë të IOPS për mbikëqyrjen, përpjekjet e mbikëqyrësve në lidhje me menaxhimin e riskut për investime alternative duhen përqëndruar në ato fusha ku mund të dalin probleme dhe ndikimi i tyre mund të jetë i gjerë. Një lokalizim i limituar i investimeve alternative nuk duhet të shoqërohet automatikisht me rritjen e qënësishme të profilit të riskut – në të vërtetë format “tradicionale” të investimit mund të mbajnë një risk të ngjashëm, bile edhe më të madh. Autoritetet mbikëqyrëse mund ta shikojnë si të leverdisshme adaptimin e monitorimit off-site për të marrë informacion ose të analizojnë nivelin e fondeve ku investimet në asete alternative duken veçanërisht të larta, ose mbi bazen ad-hoc.

GP e IOPS në menaxhimin e riskut të investimeve alternative nga fondet e pensioneve, të përshkruara në këtë dokument, mund të ndihmojnë autoritetet mbikëqyrëse të fokusojnë përjasjen e tyre të përgjithshme mbikëqyrëse në çeshtje të paraqitura nga fondet e pensioneve dhe menaxhimin e riskut të këtyre aseteve. GP jep ndihmesë në shqyrtimin e menaxhimin e riskut të investimeve alternative, në veçanti më pak likuide, më pak transparente, me risk të lartë. GP janë skicuar që të ndihmojnë vlerësimin në kontekstin e mbikëqyrjes “në bazë parimesh”.

GP reflektojnë çfarë autoritetet e mbikëqyrjes presin zakonisht të shikojnë kur vlerësojnë menaxhimin e riskut të fondeve të pensioneve që investojnë në investime alternative. Karakteri i GP thekson parimin prioritar që është përgjegjësia e fondeve të pensioneve për të zhvilluar politikat e investimet të tyre alternative në mënyrë të përgjegjshme. Si të tilla, GP gjithashtu mund të ndihmojnë dhe inkurajojnë fondet e pensioneve të përmirësojnë praktikat e tyre të menaxhimit të riskut. Pavarësisht nga këto GP të mbikëqyrjes, përgjegjësia e fundit për zhvillimin e praktikave më të mira dhe veprimin korrekt të fondeve të pensioneve mbetet në menaxhimin e fondeve të pensioneve.

<sup>3</sup>Due diligence – nënkupton një kontroll tërësor, por për arsye të hyrjes së këtij termi në fjalorin e fushës si të tillë, në material do ta përdorim në Anglisht.

## Praktika të Mira (GP) në Menaxhimin e Riskut të Investimeve Alternative nga Fondet e Pensioneve

### 1 -Karakteristikat e investimeve alternative

*GP 1: Autoritetet Mbikëqyrëse kërkojnë që një fond pensionesh të veprojë me due diligence kur vlerëson investimet alternative për t'u siguruar që marrin plotësisht në konsideratë riskun specific dhe karakteristikat e kthimit të këtyre investimeve.*

o Është e zakonshme për Autoritetet Mbikëqyrëse të kërkojnë që fondet e pensioneve të njohin rangun e riskut me të cilin përballen në mënyrë që ta vlerësojnë dhe menaxhojnë atë në mënyrë efektive. Duke ditur që investimet alternative karakterizohen shpesh nga risk dhe profil kthimi divergjent dhe asimetrik, transparencë e likuditet të limituar, vlerësimi korrekt i riskut dhe menaxhimi i këtyre instrumentave është veçanërisht i rëndësishëm dhe ka të ngjarë të ketë karakteristika të qënësishme të ndryshme dhe komplekse nga menaxhimi i riskut i shumicës së instrumentave tradicionale. Një numër risqesh janë të pranishme në investimet alternative, përfshirë riskun e likuditetit, riskun operacional, riskun kundra-parti, riskun e reputacionit, dhe risqe që lidhen me outsourcing /delegimin e detyrave të tretet. Gjithashtu, për disa produkte, kthimi varet shumë nga aftësitë drejtuese sesa nga performanca e klasës së asetit. Për këto arsye indikatorët e riskut dhe kthimit tradicional nuk japin domosdoshmërisht një pamje adekuate të karakteristikave specifike të investimeve alternative. Shifrat historike të kthimit janë shpesh të devijuara ose nuk përfaqësojnë investimet specifike.

Për pasojë autoritetet mbikëqyrëse duhet të marrin në konsideratë si ato mund të sigurojnë dhe inkurajojnë fondet e pensioneve për të vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe menaxhuar riskun potencial që keto investime mund të kenë.

<sup>3</sup> Due diligence – nënkupton një kontroll tërësor, por për arsye të hyrjes së këtij termi në fjalorin e fushës si të tillë, në material do ta përdorim në Anglisht

### 2 -Politika e portofolit & strategjia e investimit

*GP 2a: Autoritetet Mbikëqyrëse presin që investimet e një fondi pensionesh në asete alternative të përkojnë me strategjinë e përgjithshme të fondit të pensioneve, të bëhen llogaritje të mira nga fondet e pensioneve për profilin e riskut total, duke përfshirë lidhjen midis investimeve alternative nga njera anë dhe portofolin total të investimeve dhe natyrën dhe madhësinë e detyrimeve nga ana tjetër.*

*GP 2b: Autoritet Mbikëqyrëse presin që fondet e pensioneve të verifikojnë në intervale të rregullta që diversifikimi përgjatë starategjisë së investimit të jetë adekuat dhe që përqëndrimet e padëshirueshme në portofole të evitohen.*

o Autoritetet Mbikëqyrëse presin që fondet e pensioneve të vendosin paraprakisht karakteristikat e kthimit dhe riskut të investimeve në të cilat duan të investojnë, duke përfshirë gjërësinë e shpërndarjes së riskut. Ky vendim duhet marrë brenda kuadrit të politikës së investimeve strategjike. Proçesi i zgjedhjes të investimeve alternative duhet gjithashtu të jetë në linjë me politikën e investimeve strategjike të fondit. Karakteristikave divergjente të investimeve alternative i duhet dhënë një konsideratë e duhur nëpërmjet përdorimit të një infrastrukture të përshtatshme (psh kapacitete, sisteme). Analiza e riskut përbën bazën për të vendosur nëse investimet alternative përshtaten me natyrën dhe madhësinë e detyrimeve të fondit të pensioneve. Vlerësimi i riskut duhet të shqyrtojë karakteristikat specifike të investimeve alternative, psh nëpërmjet aplikimit të proçedurave të përshtatshme të testimit të stresit. Aspekte të tjera që luajnë rol në zgjedhjet e investimeve strategjike përfshijnë: strukturën e investimit (fonde çader ose menaxhim vetë), likuiditetin e kërkuar, kostot, por gjithashtu nivelin e dijës së kërkuar (i cili mund të fitohet pjesërisht nga të tretet).

o Diversifikimi i mjaftueshëm i investimeve është esencial, brenda portofolit total dhe brenda portofolit të investimeve alternative. Portofolet jolikuide shpesh mund të lëvizin në harmoni në raste të caktuara stresi. Ekspozime të tilla të zakonshme mund të mos kapen në një analizë normale mesatare-variacion.

### 3 -Due diligence

*GP 3a: Autoritetet Mbikëqyrëse presin që, kur fondet e pensioneve vendosin të investojnë në investime alternative, të kenë një kuptim të qartë të karakteristikave të riskut të investimeve alternative në të cilat po investojnë dhe që ky kuptim i riskut të mbështetet nga analiza në intervale të rregullta të profilit të riskut të strategjive të investimit dhe kapaciteteve të menaxherëve të fondeve në të cilat fondet e pensioneve kanë investuar ose kanë ndërmend të investojnë. Analiza duhet bazuar në informacion në kohë dhe të mjaftueshëm rreth fondeve dhe menaxherëve të tyre, kështu që të mund të bëhet një vlerësim i pavarur.*

*GP 3b: Autoritetet Mbikëqyrëse i kushtojnë një vëmendje të madhe informacionit që fondet e pensioneve mbajnë rreth (fondeve të) fondeve të investimeve ku ato mbështeten. Reportet e gjeneruara sipas (fondeve të) fondeve duhet të përdorin instruksione të drejta vlerësimi, duhen dhënë në kohë, dhe duhet të kenë siguri cilësore të mjaftueshme.*

*GP 3c: Autoritetet Mbikëqyrëse presin që çdo vlerësim i fondeve të fondeve të përfshijë një gjykim të cilësisë së menaxhimit të riskut të realizuar nga fondi i menaxherëve të fondeve dhe respektimin e standarteve dhe kriterëve të vërejtura.*

o Menaxheret e kujdestarëve të besuarve përgjegjës për një fond pensionesh nuk duhet të ndërmarrin investime alternative nëse ato nuk kuptojnë plotësisht karakteristikat e investimit në fjalë, dhe riskun që e shoqëron. Ata duhet të evitojnë investimet që nuk i kuptojnë.

Investigimi due diligence është faza më e rëndësishme e procesit në lidhje me investimet në fonde investimesh alternative, sepse ai aftëson të interesuarit të konfirmojnë nëse të kuptuarit e tyre është i saktë.

Për arsye se fondet e investimeve janë shpesh të bazuar off-shore dhe mund të jenë subjekt i pak mbikëqyrjeje, nëse ka, kërkohet një investigim due diligence ekstensiv.

o Kur fondet e pensioneve vlerësojnë investimet alternative, pikat e vëmëndjes në procesin due diligence mund të ndahen në vija të përgjithshme në tre: njerëzit, proceset dhe performanca. Vlerësimi i njerëzve shikohet në të dy menaxhim dhe staf, aspektet kyç janë risku i integritetit dhe ekspertizës së skuadrës menaxhuese. Vlerësimi i proceseve përqëndrohet tek faktorët të tillë si organizimi i fondeve të pensioneve, proceset operacionale dhe të menaxhimit të riskut, procesi i investimeve dhe proceset që rrethojnë çdo outsourcing/delegim në palët e treta, përfshirë përdorimin e sistemeve të përshtatshëm dhe ekzistencën e planeve të emergjencës. Një vlerësim i performancës duhet të përfshijë një vlerësim të mënyrës në të cilën vlerësimi i fondit është prekur dhe, deri sa është e mundur, një analizë të rekordeve të gjurmëve të menaxhimit. Për autoritetet mbikëqyrëse është e përshtatshme të verifikojnë nëse fondet e pensioneve sigurojnë që investimet e tyre alternative përputhen me praktikatat e mira të industrisë (në lidhje me menaxhimin e riskut, raportimin dhe kontrollin e brendshëm), duke përfshirë në cilën shkallë zë vend vlerësimi i pavarur i proceseve dhe sistemeve të ofruesit të investimeve alternative. Due diligence duhet gjithashtu të përfshijë një vlerësim të aspekteve fiskale dhe ligjore të (dokumentacionit të) investimeve nën shqyrtim.

o Një çështje kyç për t'u adresuar në vlerësimin e due diligence dhe monitorimin e proceseve të fondeve të pensioneve është nëse vëmëndje e duhur i kushtohet vlerësimit. Fondet e pensioneve kanë nevojë të vlerësojnë madhësinë në të cilën vlerësimet janë bërë në mënyrë të pavarur dhe si është ruajtur kjo pavarësi.

<sup>5</sup> Off-shore – këtu nënkupton janë të shkëputur ose në distancë

Midis të tjerash duhen shqyrtuar gjithashtu: (përshtatshmëria) metoda e përdorur e vlerësimit, procedurat e vlerësimit dhe të testit provë rreth modelit të çmimit, verifikime të pavaruara dhe frekuencën e vlerësimeve.

o Nëse një fond pensionesh merr pjesë në fonde çadër (dmth një fond investimesh i cili vetë investon në disa nën-fonde të ndryshëm), atëherë procesi due diligence konsideron disa aspekte shtesë, të ngritura prej futjes së një shtrese shtesë menaxhimi.

#### 4 -Termet e kontratës dhe monitorimi

*GP 4: Autoritetet Mbikëqyrëse presin që investimet alternative të një fondi pensionesh të bazohen në terma adekuate kontrate. Kjo dmth, këto terma duhet të nënvizojnë një kufizim të qartë të riskut me qëllim që të limitohen humbjet financiare potenciale, masat që duhen marrë në rast se preken kufijtë lejuar, transparencën adekuate, një përkrahje të qartë të periudhave të mbyllura (lock-up), dhe në përgjithësi kushtet dhe pagesat eksplicite në rast të anulimit dhe përfundimit/mbylljes. Përbushja e termave të kontratës duhet monitoruar rregullisht dhe sistematikisht nga fondet e pensioneve.*

o Specifikimet e termave adekuate të kontratave varen nga karakteristikat e fondeve të pensioneve dhe investimeve nën shqyrtim. Termet e çdo kontrate të firmosur midis një fondi pensionesh dhe një ofruesi investimesh alternative duhet të lejojne fondin e pensioneve të realizojë menaxhim adekuat të riskut. Është e rëndësishme të verifikohet se fondi i pensioneve ka mbërritur në një anulim të marrëveshjes, e cila e le fondin e pensioneve si të tërë “në kontroll”. Duhet përcaktuar një politikë prudente investimesh, në linjë me interesat e palëve të interesit (stakeholders) dhe për të arritur një të ardhur të përshtatshme në lidhje me riskun e ndodhur dhe detyrimet/përgjegjësitë e mbuluara. Me qëllim të parandalimit të humbjeve për shkak të përgjegjësitë të palëve të treta (TPL), fondet e pensioneve duhet të përdorin një strukturë të kufizuar të përgjegjësisë.

o Investimet alternative nuk mund të konsiderohen si pasive. Me qëllim të sigurimit të fleksibilitetit optimal operacional në tregjet financiare, fondet e investimeve alternative mund të vendosin të mos përcaktojnë qartë strategjitë në prospektet e tyre. Kontrolli i shpeshtë dhe në menyrë aktive i performacës së fondit dhe menaxhuesve të fondit si dhe verifikimi i përmbushjes së marrëveshjeve, i jep mundësi fondit të pensioneve të ndërhyjë në faza të hershme, nëse nevojitet. Ndërhyrjet në kohë mund të parandalojnë humbje të mëdha. Procesi i monitorimit mbulon jo vetëm aspektet e investimit por gjithashtu çështjet operationale. Kur një fond pensionesh merr pjesë në një fond fondesh, procesi i monitorimit është pjesërisht i deleguar tek të tretët (outsourced). Në këtë rast, fokusi i fondit të pensioneve kalon prej fondit mbështetës në fondin e fondeve.

o Pasja e ndërveprimeve/kontakteve të rregullta me menaxherët e investimeve të tyre alternative, veçanërisht ku një pjesë e konsiderueshme e investimeve janë në një menaxher të caktuar, mund të lehtësojë fuqimisht procesin e monitorimit të fondit. Kjo mund të përfshijë pyetesorë të rregullt ose vizita në vend (on-site) dhe gjithashtu mund të përfshijë angazhimin e konsulentëve specialistë për të ndihmuar në procesin e monitorimit.

o Ekzistenca e letrave anësore, që ofrojnë terma preferenciale investitoreve të caktuar, mund të ndikojë në menyrë të ndjeshme në profilin e riskut të investimeve. Prandaj është e rëndësishme për fondet e pensioneve të sigurohen se menaxheret e investimeve të tyre nuk ofrojnë këto lehtësira ose se ata janë totalisht transparent dhe të kompensuar. Kjo duhet të reflektohet në termat e kontratës.

#### 5 -Komunikimi

*GP 5: Autoritetet Mbikëqyrëse presin që një fond pensionesh të jetë transparent në komunikimin e tij me palët e interesit (stakeholders) rreth politikave në lidhje me investimet alternative dhe objektivat që kërkon të arrije në lidhje me këtë.*

o Duke ditur nivelin potencial të moskuptimit dhe debatit rreth investimeve alternative, fondet e pensioneve duhet t'u bëjnë të ditur palëve të interesit (stakeholders) politikën e tyre të investimeve dhe praktikat e menaxhimit të riskut qartësisht dhe saktësisht. Një komunikim i tillë formon bazën për një transparencë të plotë të informacionit kyç për zhvillimin e biznesit dhe qëndrueshmërinë financiare. Kjo mund të ndihmojë për të menaxhuar riskun e reputacionit vetjak të fondit të pensioneve.

## 6 -Kalimi/delegimi i detyrave te të tretët (Outsourcing)

*GP 6: Autoritetet Mbikëqyrëse presin që nëse përdoret outsourcing, fondet e pensioneve mbeten përgjegjës, dhe kështu sigurojnë menaxhim adekuat të riskut për investimet alternative.*

o Fondet e pensioneve shpesh i kalojnë aktivitete palëve të treta, mundësisht duke përdorur shoqëritë brenda grupit të cilit i përket fondi i pensioneve. Në rast të outsourcing, Autoritetet Mbikëqyrëse presin që fondet e pensioneve të sigurojnë që palët e treta në shqyrtim i përbushin rregullat e aplikuara nga vetë fondet e pensioneve. Në rast të përdorimit të outsourcing, menaxhimi i riskut të fondit të pensioneve fokusohet në procesin e përzgjedhjes, negociatat për një kontratë të mirë, vlerësimi dhe monitorimi i procesit të menaxhimit të riskut dhe aspekte të tjera të palëve të cilave iu delegohen detyrat.

o Parimi bazë është që një fond pensionesh të sigurohet që menaxhimi i riskut të palëve të treta të jetë adekuat. Për këtë qëllim, për autoritetet mbikëqyrëse, fondet e pensioneve vetë mbeten pika kryesore e kontaktit. Çështja kyçe për të vlerësuar është si fondet e pensioneve sigurojnë që palë e treta realizojnë një menaxhim të mirë të riskut për detyrat e deleguara.

o Nëse, në bazë të informacionit të marrë nga fondi (ose në mënyra të tjera), nuk është e mundur të përcaktohet nëse detyrimet për menaxhim adekuat të riskut janë përbushur në përputhje me aktivitet e subkontraktuara, Autoritetet Mbikëqyrëse mund të vendosin, kur është e mundur, të bëjnë investigime të mëtejshme në palët të cilave iu janë deleguar detyrat. Sidoqoftë, fondi i pensioneve mbetet përgjegjës dhe kështu siguron, menaxhim adekuat të riskut për investimet alternative.

## Vështrim mbi tregun e Sigurimeve

Në muajin Janar 2008, primet e shkruara bruto kapën vleren prej 479,800 mijë lekë, përkundëjt 436,599 mijë lekë të realizuara në muajin janar 2007.

Tregu i sigurimeve ka një rritje në masën 9.89% në krahasim me muajin janar të vitit të kaluar, ku 82.36% e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo- Jetës, ndërsa 17.64% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 40.01% të sigurimeve të Jetës dhe 8.52% të sigurimeve të Jo –Jetës.

Në muajin Janar 2008, volumi i primeve të Sigurimit të Detyrueshëm dhe të Sigurimit Vullnetar në aktivitetin e Jo-Jetës janë rritur me 6,39% dhe 12,36% respektivisht në krahasim me muajin Janar 2007. Gjithashtu vlen të përmendet pesha që ka portofoli MTPL në rritjen e tregut është 72.33%.


Në muajin Janar 2008 u lidhën 41,504 kontrata sigurimi përkundëjt 34,331 kontrata të lidhura në muajin Janar 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo-jetës kapi vlerën 37,460 nga 32,635 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 2,787 kontrata ose në masën 57.76 %.

Vlen të përmendet rritja në masën 138.44 % e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundëjt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 4,044 nga të cilat sigurimi “Nxënësi e Studenti” ka një rritje prej 1,020 kontrata , duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.


Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në muajin Janar (2007 – 2008)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
Periudha Janar	2007	2008
A) Sigurim i Jetës	19,052	26,674
B) Sigurim i Jo - Jetës	417,547	453,126
<i>nga këto</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	295,313	315,787
b) Sigurimi Vullnetar	122,233	137,339
<b>TOTAL</b>	<b>436,599</b>	<b>479,800</b>

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në muajin Janar 2008 (Jeta dhe Jo Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për muajin Janar 2008 (Jo-Jeta)





## XBRL : Drejt një gjuhe të përbashkët të Raportimit Financiar

Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) ka qenë në biznesin e vendosjes së standarteve për 23 vjet. Paraqitjet e saj ndërkombëtare kanë fituar mbështetjen për cilësinë e lartë, aktualitetin dhe përshtatshmërinë në kuadrin e harmonizimit global. Në një pamje të zgjeruar, IFAC po punon me rregullatorë, agjensi ndërkombëtare dhe të tjerë për të inkrajuar qeveritë në prezantimin e strukturave, sistemeve dhe kontrolleve të cilat bëjnë një qeverisje të mirë. Forumi Ndërkombëtar për Zhvillimet në Kontabilitet (IFAD) <sup>6</sup>, i lançuar prej palëve të interesuara vitin e kaluar, do të përforcojë kapacitetet e kontabilitetit dhe do të ndihmojë në sferën kombëtare gjithashtu duke ndërtuar një platformë për një arkitekturë financiare të fortë mbarë globale.

XBRL është një gjuhë elektronike e cila përdoret për të formatuar raporte financiare me qëllim transportimin e tyre nëpërmjet internet explorer.

Ndërtuesit dhe përdoruesit e informacioneve financiare mund ta shkëmbejnë XBRL midis të gjithë software-ve dhe teknologjive që të sigurojnë një efikasitet të mirë në tregun global të kapitalit. XBRL nënkupton “Gjuhë Raportesh Biznesi”. Ajo është nënbashkësi, platformë e pavarur, metodë standartizuar e shkëmbimit të informacionit. Ajo mund të përdoret në mënyrë të pavarur ose të inkorporuar brenda kompjuterave të tjerë që kërkojnë fleksibilitet në shpërndarjen e informacionit. XBRL u zhvillua nga Komuniteti Ndërkombëtar i Projektit të XBRL i përbërë nga organizatat që përfaqësojnë zinxhirin e ofertës së informacionit financiar, duke përfshirë disa prej anëtarëve të bordit të IFAC-së.

### Si funksionon

Kjo gjuhë e bazuar në XML, etiketon në mënyrë automatike dhe transparente çdo segment të informacionit të kompjuterizuar të biznesit me një kod identifikimi. Këto shënues qëndrojnë të lidhur me informacionin pavarësisht mënyrës së formatimit apo ndreqjes së informacionit nga një kërkues (shfletues) apo nga përbrenda aplikimeve të programit.

Përpara XBRL, nuk kishte një format të përbashkët për raportimin e të dhënave të biznesit. Detyra intensive e përgjegjësive për futjen dhe rifutjen e të dhënave në programet kompjuterike, paraqet shpenzime të konsiderueshme si dhe rrezikshmëri në hedhjen e të dhënave. Përdorimi i XBRL e kanalizon këtë proces duke ulur potencialisht nivelin e shpenzimeve dhe duke ruajtur/siguruar ndërkohë integritetin dhe cilësinë e këtyre të dhënave.

Me XBRL, në një kohë që informacioni financiar është krijuar dhe formatuar për herë të parë, të dhënat pasqyrohen në të gjitha format. Formulim financiar i shtypur, dokumente të HTML, një skedar rregullues, një skedar HML, raporte krediti ose aplikime borxhi, mund të krijohen pa rihedhur apo riformatuar informacionin në një kohë të dytë.

XBRL nuk ndryshon standartet ekzistuese të kontabilitetit dhe as nuk detyron shoqëritë të nxjerrin informacion shtesë. Ky program, thjesht shton mundësinë e marrjes dhe përdorimit të informacionit financiar që i kërkohet shoqërive për të raportuar.

<sup>6</sup> IFAC - International Federation of Accountants, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve

<sup>7</sup> IFAD – International Forum on Account and Development, Forumi Ndërkombëtar për Zhvillimet në Kontabilitet



## Kush përfiton

Duke siguruar më tepër lehtësi në marrjen e të dhënave të përshtatshme nga shoqëritë financiare dhe më tepër efikasitet në aftësitë analizuese, XBRL do të shtojë vlefë të çdo njeri që krijon ose merr të dhënat e një organizate biznesi.

*Së fundmi, XBRL i sjell dobi të gjithë përdoruesve në zinxhirin e ofertës të informacionit financiar:*

Kompani publike dhe private, kontabilistëve, rregullatorëve, analistëve, komuniteti investues, tregjet e kapitalit dhe kreditorët, palëve të treta, si psh. zhvilluese të software-ve dhe grumbulluesve të të dhënave.

Duke siguruar informacionin e përshtatshëm dhe të besuar, XBRL u jep lidërve të industrive mundësi më të mira informimi për vendime biznesi më të mira. Eventualisht, XBRL do t'i mundësojë menaxhuesve të kompanive marrje më të shpejtë të informacioneve të ruajtur në vënde të ndryshme brenda organizatës dhe levizjen e këtyre informacioneve si brendapërbrenda kompanive ashtu dhe tek aksionerët respektiv. Duke shpenzuar më pak kohë me përkthimin dhe hedhjen e të dhënave, investitorët të mëdhej dhe të vegjël, mund t'i kushtojnë më shumë kohë analizës dhe mbase të skanojnë më tepër kompani për mundësi investimi. Kjo gjë mund të ndihmojë ato kompani të cilat zakonisht nuk arrinë të identifikohen nga radarët investues.

XBRL do të mund të ndihmojë kompanitë e shërbimeve financiare të mblidhen dhe të rifreskojnë informacione rreth huamarrësve, raporteve të automatizuara për rregullatorët dhe të shpërndajë ose mbledhë informacion lidhur me shit-blerje nga portofole huaje.

Institucionet e Kontabilitetit në mbarë botën e shohin zhvillimin e XBRL si një tjetër hap në vijimësinë e qartësimit dhe zhillimit të gjuhës themelore të biznesit dhe si mjet i rëndësishëm për përmirësimin e marrjes dhe vënies në dispozicion të publikut investues të informacionit financiar.

Për më tepër XBRL do të ndihmojë në pozicionimin e

kontabilistëve për dhënien e njohurive për klientët apo firmat që ato përfaqësojnë. Gjithashtu do të ndihmojë në mekanizmat e biznesit, kontabilistët me zbatimet e tyre në teknologjitë e tipit XBRL dhe mund të rrisin mundësitë dhe aftësitë e tyre në treg.

## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### **Konferenca Rajonale “Roli i institucioneve rregullatore në sigurimin e pensioneve tërësisht të kapitalizuara në linjë me plotësimin e Direktivave të BE”**

Në datën 30 Janar 2008, në Shkup të Maqedonisë u zhvillua konferenca rajonale

*“Roli i institucioneve rregullatore në sigurimin e pensioneve tërësisht të kapitalizuara në linjë me plotësimin e Direktivave të Bashkimit Europian”.*

Seminari u realizua nga Këshilli i Europës nën *“Programin e mbrojtjes së institucioneve sociale”* të CARDS.

Në konferencë u trajtuan eksperiencat e disa vendeve si Holanda, Bullgaria, Sllovenia dhe Maqedonia. Gjithashtu, edhe vendet pjesëmarrëse (të rajonit) paraqiten shkurtimisht modelin e tyre në fushën e pensioneve dhe të mbikëqyrjes.

Në lidhje me eksperiencën e Hollandës mund të veçojmë që sistemi i tyre i pensioneve është sistem me tre kolona.

o Kolona a parë – shtetore, PAYG, kontributet nëpërmjet taksave të të ardhurave personale, përfshin të gjithë qytetarët, e detyrueshme.

o Kolona e dytë – private, me fonde të kapitalizuara, e lidhur me punësimin, kontributet paguhen nga punëdhënësit/punëmarrësit, “vullnetare”, menaxhohet nga fonde pensionesh dhe shoqëri sigurimi, kolektive.

o Kolona e tretë – private, me fonde të kapitalizuara, vullnetare, menaxhohet vetëm nga shoqëri sigurimi, individuale.

Është e rëndësishme të evidentohet që kolona e parë realizon një përfitim flat-rate për të gjithë qytetarët, fondet e pensioneve (të kolonës së dytë) janë autonome dhe nuk kanë lidhje me shoqëritë sponsorizuese (konform me direktivat e BE), dhe në kolonën e tretë janë kryesisht të vetëpunësuarit.

Në kolonën e dytë dhe të tretë primet e pensioneve (kontributet) janë të përjashtuar/zbritshme nga taksat (tax-deductable). Skema e pensioneve realizon një shkallë zëvendësimi 70% dhe është me përfitime të përcaktuara (DB).

Në Hollandë, mbikëqyrja është e integruar për pensionet, sigurimet, bankat dhe letrat me vlerë.

*Parimet bazë të mbikëqyrjes janë:*

o në bazë parimesh/rregullash;

o e orientuar në bazë të riskut;

o integriteti;

o transparenca nëpërmjet përdorimit të TIK

(teknologjisë së informacionit dhe komunikimit).

Eksperienca Sllovene flet për një sistem tre kolonësh gjithashtu. Mbas realizimit të reformës parametrike të sistemit PAYG, në Slloveni u futën skemat private të pensioneve:

o skema profesionale e detyrueshme e pensioneve për profesionet e vështira dhe të rrezikshme (e cila funksionon nëpërmjet menaxhimit të një kompanie me kapital shtetor (Kompania Kapital), kontributet paguhen nga punëdhënësi, e ngjashme me kolonën e dytë sipas klasifikimit të BB);

o pjesëmarrje vullnetare në planet e pensioneve private plotësisht të kapitalizuara (plane kolektive të sponsorizuara nga punëdhënësi, individuale/ primet e pensioneve paguhen në menyrë individuale, kolonë e tretë sipas klasifikimit të BB).

*Lëvruesit e skemave të pensioneve në Slloveni janë:*

o Fonde të përbashkëta pensionesh të hapura ose të mbyllura, të menaxhuara nga një bankë, kompani sigurimesh ose Kompania Kapital; jo një person juridik, i menaxhuar vetëm për përfitimin e anëtarëve, pronësia e ndarë nga sponsorizuesi dhe kompania menaxhuese, asetet në kujdes të një banke kujdestare,

o Fonde të përbashkëta pensionesh të mbyllura formohen dhe sponsorizohen nga sipërmarrje të caktura, anëtarësimi në fond i mundshëm për punonjësit e punësuar në kompaninë sponsorizuese,

o Kompanitë e pensioneve mund të jenë një kompani aksionere, kompani sigurimi jete e specializuar, mbledh primet dhe paguan anuiti, asetet në kujdestar,

o Kompani sigurimi jete mund të themelojnë dhe drejtojnë një skemë pensionesh, të ndarë nga biznesi i sigurimeve.

Sistemi i pensioneve të Maqedonisë është tre kolonësh. Kolona e parë e detyrueshme, PAYG, kolona e dytë e detyrueshme, totalisht e kapitalizuar, kolona e tretë vullnetare, totalisht e kapitalizuar. Kolona e dytë dhe e tretë përfshin të gjithë punëmarrësit e punësuar pas datës 1 Janar 2003. Masa e kontributit 21.2% e pagës bruto (13.78% kolona e parë dhe 7.42% kolona e dytë). Kanë sistem mbikëqyrjeje jo të integruar, dmth kanë me vete agjencinë e mbikëqyrjes së pensioneve private e cila funksionon mbi bazën e parimeve të mbikëqyrjes mbi bazë rregullash, mbikëqyrjen on-site dhe off-site dhe po zhvillojnë përqasjen e mbikëqyrjes mbi bazë risku.

Konferenca nënvizoi rrugën që duhen të ndjekin vendet e rajonit përfshi edhe Shqipërinë, në lidhje me adoptimin e direktivave të BE në ngritjen e skemave të pensioneve dhe të mbikëqyrjes së tyre.

### **Konferenca Rajonale "Reformat ligjore në rajonin e Ballkanit, për mbrojtjen e konsumatorit në fusha të ndryshme dhe shërbimet financiare jobankare"**

Në datat 4 dhe 5 shkurt 2008, u organizua në Zagreb të Kroacisë takimi rajonal mbi reformën ligjore në rajonin e Ballkanit, për sa i përket mbrojtjes së konsumatorit në fusha të ndryshme ndër të cilat dhe ajo për shërbimet financiare jobankare. Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë të shteteve pjesëmarrëse.

### **Zhvillimi i Konferencës**

Takimi u zhvillua sipas programit që ishte përcaktuar më parë nga organizatorët e GTZ.

Në ditën e parë të takimit, u bë hapja nga përfaqësuesja e GTZ së Maqedonisë, nga përfaqësuesja e BE si dhe nga përfaqësuesja e Ministrisë së Ekonomisë të Kroacisë, më pas u kalua në prezantimet e çdo shteti të dhëna nga ministrinë e Integritimit ku u paraqitën arritjet e deri tanishme në përmirësimin dhe përafrimin e legjislacionit me vendet e BE. Në pjesën e dytë të ditës së parë të takimit pjesëmarrësit paraqitën arritjet respektive në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Nga ana e delegacionit shqiptar prezantimi u paraqit nga përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë. Në këtë prezantim u paraqit dhe pjesa që i takon AMF për sa i përket mbrojtjes së konsumatorit si dhe përmirësimin e legjislacionit të kësaj fushe nga ana jonë.

Pas prezantimit që u bë nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, pati diskutime dhe pyetje për sa i përket eksperiencave respektive në fushat e ndryshme të mbrojtjes së konsumatorit. Vlen të përmendet që ky takim ishte i orientuar kryesisht në fushën e mbrojtjes së konsumatorit nga ushqimet (food safety) dhe diskutimet e pyetjet që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit në fushën e shërbimeve financiare jobankare ishin të pakta. Sidoqoftë, në takimin e rradhës prioritet do t'i jepet diskutimit të mbrojtjes së konsumatorit dhe përafrimit të legjislacionit në fushën financiare në përgjithësi, ku do të përfshihet dhe sektori financiar jobankar. Në ditën e dytë të takimit të grupit të punës, diskutimet u mbajtën nga përfaqësuesit e shoqatave të mbrojtjes së konsumatorit të vendeve pjesëmarrëse. Nga ana e Shqipërisë nuk kishte përfaqësues të shoqatës së mbrojtjes së konsumatorit dhe për rrjedhojë nuk pati diskutim nga ana e përfaqësuesve shqiptarë.

Në përfundim vlen të theksohet se diskutime të tilla midis vendeve të rajonit që aspirojnë të hyjnë në BE janë shumë të vlefshme, jo vetëm për rëndësinë që kanë por dhe për faktin se shërbejnë për shkëmbimin dhe marrjen e eksperiencës.

### **Për këtë numër punuan:**

E. Shehi, R. Guri, E. Beqir-Aga,  
E. Sofroni, L. Lloji, D. Tahiraj

